



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:233805

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05772241

Ac.nr.4704/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Ylber Shurdhiqi dhe Adnan Konushevc, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses N.P. me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.G., zyrtare ligjore në kompaninë D.L.R., kundër të paditurve H.M dhe A.Sh. nga Prishtina, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson H.P., avokat nga Podujeva, me objekt kontesti kthim i kredisë, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarës së paditëses, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1055/2015 të datës 06.05.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e të autorizuarës së paditëses N.P. me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1055/2015 i datës 06.05.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.1055/2015 të datës 06.05.2021, në pikën një të dispozitivit ka refuzuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses N.P. me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohen të paditurit H.M. dhe A.Sh. që paditëses në emër të kthimit të kredisë së papaguar t'ia paguaj shumën prej 8934.18 euro, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim. Në pikën dy, ka caktuar që secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur paditësi, për shkak të shkeljes dispozitive të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike

si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit, ta aprovoj ankesën dhe të prish aktgjykimin C.nr.1055/15 të datës 06.05.2021, dhe çështjen ta kthej në rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar i autorizuari i të paditurve duke i kundërshtuar pretendimet ankimore, me propozim që gjykata e shkallës së dytë të refuzoj si të pabazuar ankesën e paditëses ndërsa aktgjykimin C.nr.1055/15 ta vërtetoj.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, me padinë e parashtruar në gjykatën e shkallës së parë, me datën 05.05.2015, ka kërkuar që të detyrohen të paditurit për kthimin e kredisë në shumë prej 8934.18 euro. Në përgjigje në padi i autorizuari i të paditurve ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë për shkak të parashkrimit duke propozuar që e njëjta të refuzohet si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me të cilën e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar për shkak të parashkrimit duke u bazuar në dispozitën e nenit 360 dhe 371 të LMD-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 181 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar për shkak të parashkrimit, pasi që duke u bazuar në dispozitën e nenit 371 të LMD-së, (Ligji i RFSJ-së, i cili ligj ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridik), përcaktohet se: “*Kërkesat parashkruhen për 5 vjet në qoftë se me ligj nuk është caktuar afat tjetër i parashkrimit*”. Sipas kërkesëpadisë së paditëses rezulton se një kërkesë e tillë është e parashkruar pasi në rastin konkret paditësja me të paditurit ka lidhur kontratën për kreditinë me datën 11.05.2005, ndërsa afati për kthimin e kredisë ka qenë 24 muaj pas marrjes së të njëjtës, përkatësisht deri me datën 11.05.2007. Sipas dispozitës së nenit 361, paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “*Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkoj përmbushjen e detyrimit në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër*”. Në këtë rast, afati i parashkrimit ka filluar të rrjedh nga data

11.05.2007, kur kreditori ka pasur të drejtë që kë të kërkoj përmbushjen pas kalimit të afatit prej 24 muaj, për shkak të rënies në vonesë të debitorit, ndërsa paditësja padinë në gjykatë e ka paraqitur me datën 05.05.20015, dhe se nga shkresat e lëndës rezulton se padia është paraqitur jashtë afatit 5 vjeçar të parashkrimit. Afati i parashkrimit është koha e caktuar me ligj në bazë të cilit mund të kërkohet ndonjë e drejtë dhe se pas kalimit të këtij afati, e drejta e kërkesës nuk mund të realizohet përmes rrugës gjyqësore.

Është i pabazuar pretendimi ankimor i paditëses se e njëjta ka inicuar procedurë përmbartimore dhe se për të njëjtin borxh është zhvilluar procedura penale dhe se sipas nenit 388 të LMD-së, parashkrimi ndërpritet me ngritjen e padisë apo me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose organit tjetër kompetent me qëllim përcaktimi, sigurimi apo realizimi të kërkesës. Gjykata ankimore vlerëson se nuk kemi ndërprerje të parashkrimit sipas dispozitës së nenit 389, paragrafi 2 të LMD-së, përcaktohet se: *“konsiderohet se nuk ka patur ndërprerje në qoftë se padia e kreditorit ose kërkesa e tij hidhen poshtë apo refuzohen, ose në qoftë se anulohet masa e siguruar ose e ndërmarrë e ekzekutimit apo sigurimit”*. Sipas provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës përkatësisht aktgjykimi P.nr.920/2011 i datës 13.02.2012, ku është zhvilluar procedura penale ndaj të pandehurit H.M.-këtu i paditur vërtetohet se është refuzuar akuza ndërsa sipas dispozitës së lartcekur me refuzim të padisë/akuzës nuk kemi ndërprerje të parashkrimit dhe se afati i parashkrimit rrjedh edhe gjatë kësaj kohe pandërprerë.

Më tutje, gjykata e shkallës së dytë e ka vërtetuar edhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur shpenzimet procedurale, duke vlerësuar se gjykata e shkallës së parë, me të drejtë është bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo konsideroi se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4704/2021, me datë 22.05.2024

Kryetare e kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.